

Nr. 927/prot.,
/7

Tiranë, më 27.03.2024

VENDIM

Nr. 19 , datë 27.03.2024

PËR

“MIRATIMIN E BURSAVE FINANCIARE DHE PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË STUDENTËVE ME NOTË MESATARE 9-10, VITI I PARË NGA TROJET, TË CILËT STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIUMI TË CIKLIT TË PARË, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar; VKM nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit pasi mori në shqyrtim Relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 475 prot., datë 19.02.2024 “Mbi miratimin e kërkesës për përfitimin e bursës dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2023-2024, për studentët nga trojet që studiojnë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, në UMT”,

VENDOSI:

1. Të miratojë bursat financiare dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit të 2 (dy) studentëve me notë mesatare 9-10, viti i parë, nga trojet, të cilët përfitojnë trajtim me bursë dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit dhe studiojnë në një program studimi të ciklit të parë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2023-2024, sipas relacionit dhe listave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efekti financiar për trajtimin me bursë është 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë dhe efekti financiar për përjashtimin nga tarifa e shkollimit është 70,000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, i cili përballohet nga buxheti i shtetit si pjesë e grantit të mësimdhënies së vitit 2024.
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.



MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ



REPUBLIKA SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE



Adresa: Rr. e Dibrës, brënda QSU "Nënë Tereza", Tiranë. Tel.&Fax: 2362 619; Tel. 2373835;

Lista e studenteve viti i parë "Bachelor" troje viti akademik 2023-2024

Mesatare 9-10

Nr.	Dega	Emër	Atesi	Mbiemër	Mesatare
1	Fizioterapi	Shkurte	Imran	Aliji	9.72
2	Teknikë Laboratori	Aksa	Mirsad	Bakalli	9.24

Punoi: Arkenida Peçaj
Belinda Papa

Pranoi: Aferdita AGOLLI

DEKAN
Ilirjana ZEKJA

